



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr.....

Tirane, date/..../2014

Drejtuar: Z.Durim Babasi, Administrator
Shoqëria “Kegli-Duri” Shpk
Lagjja Kastrioti, ndërtesa 1(një) kateshe pranë gjimnazit në qendër,
FUSHE KRUIJE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI “BAJRAM CURRI” BLLOKU “VASIL SHANTO”
TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA “LORD BAJRON”, LAPRAKE
TIRANE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr.900, date 08.08.2005.

I nderuar zoti Babasi,

Shoqëria “Kegli-Duri” shpk është zotëruese e leje minerare te shfrytëzimit nr.900, date 08.08.2005, për Gurë Gëlqeror, ne Qarkun Durrës.

Nga struktura përgjegjëse, AKBN me shkresën nr.1912, date 25.02.2014 është propozuar revokimi i lejes nr.900, date 08.08.2005 për arsye se nuk janë paguar garancitë financiare për rehabilitimin e Mjedisit, për periudhën e viteve 2011 dhe 2012, për zonën e licencuar, duke mos respektuar kërkesat e pikës ç, nenit 47, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010.

Sa me sipër, ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304, date 15.07.2010, “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” (ku sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 ku përcaktohet shtrirja e efekteve për lejet e dhëna), **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes nr.900 date 08.08.2005.**

Ju bëjmë me dije se, brenda një periudhe 30 ditore nga ky njoftim merret vendimi për revokimin e lejes minerare si me sipër.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304, date 15.07.2010, “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

Miratoi: 1. Koli Bele, *Sekretar i Përgjithshëm*
 2. Mehmet Hasalami, *Drejtor*

Konceptoi: 1.Kujtim Gjoka, *Shef sektori*
 2. Erik Skendaj, *Jurist*
 2. Luljeta Kraja, *Specialist*
 3. Zef Lleshi, *Specialist*